



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0328

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani Anëtare dhe Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Uplift L.L.C” me seli në Prishtinë, kundër njoftimit mbi vendimin për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve-Rivlerësim” me nr. të prokurimit 616- 22-2435-2-1-1, iniciuar nga Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) me datë 31/07/2023mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “Uplift L.L.C”, me nr. 2023/0328, e datës 31/05/2023, kurse vendimi i AK Kuvendi i Komunës se Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve me numër të prokurimit 616-22-2435-2-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara me rastin e parashtimit të ankesës, me ç’rast Ankuesi duhet të paraqasë kërkesë për kthimin e mjeteve brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 30.03.2022, Kuvendi i Komunës se Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë, ndërsa hapja e ofertave është bërë me datë 12.05.2022. Me datë 15.05.2023, AK ka publikuar B58 njoftimin mbi vendimin për dhënie të kontratës për

aktivitetin e prokurimit “Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve-Rivlerësim” me numër të prokurimit 616-22-2435-2-1-1, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “Ejona sh.p.k.” Pejë.

Me datë 18.05.2023, Operatori Ekonomik “Uplift L.L.C”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK- Kuvendi i Komunës se Prishtinës, dhe me datë 26.05.2023, Autoriteti Kontraktues, Kuvendi i Komunës se Prishtinës, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar B58 njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 26.04.2023.

Me datën 31.05.2023, Operatori Ekonomik “Uplift L.L.C”, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 0328/2023, për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë-shërbim me një operator ekonomik. Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë 36 muaj, vlera e parashikuar e kontratës: 600,000.00 €

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Palët janë njoftuar palët me raportin e ekspertizës me datë: 14.06.2023, AK, Kuvendi i Komunës se Prishtinës nuk është deklaruar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq OE “Uplift L.L.C”, me datë 22.06.2023, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 14.06.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE “Uplift L.L.C” me seli në Prishtinë të aprovohet si e bazuar.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 15.05.2023, dhe lënda të kthehet në rivlerësim (*njoftimi për dhënie të kontratës*).

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtruesat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Uplift L.L.C” me seli në Prishtinë.

Pretendimin ankimor 1

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit të OE Uplift L.L.C (me teje si parashtrues i ankesës), ku AK –Komuna e Prishtinës përmes Letra standarde për tenderuesit e eliminuar dt: 15.05.23.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se tani kemi të bëjmë me lëndë të përsëritur, ku palët janë të njëjta, ndërsa në raportin paraprak të datës 27.10.2022, me nr.522/22, kemi dhënë rekomandimin tonë në lidhje me arsyet e eliminimit të OE ankues, rrjedhimisht Paneli Shqyrtues me datë 29.12.2022 ka nxjerr vendim, duke e aprovuar ankesën si të bazuar dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim. Sipas vendimit të Panelit Shqyrtues, AK e kishte kthyer lëndën në rivlerësim.

AK Komuna Prishtinë, pas ri vlerësimit të ofertave, e ri rekomandon për dhënie të kontratës OE të njëjtë, ndërsa e eliminon ofertën e parashtruesit të ankesës me arsyetimin e njëjtë se “Nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme siç është përshkruar në nenin 69 të LPP-së” në lidhje me Kërkesa 2 pika c. 3 ekipe me nga 2 teknikë. Minimumi 3 vite përvojë pune në punë të ngjashme. Pas shqyrtimit të kërkesës së dosjes së tenderit, konkretisht “Kërkesa 2” të FDT-së dhe analizimit të arsyes së eliminimit të OE ankues, gjejmë se AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar ka potencuar se teknikët që plotësojnë kërkesën e AK-së janë:

1. Fatos Maloku;
2. Arbër Sadiku;
3. Ardian Ferizi;
4. Fatmir Berisha, dhe
5. Florian Sadiku.

Ndërsa për tekniket tjerë, për Bashkim Rafuna potencon se pas sqarimeve shtesë, është kërkuar që të dorëzoni diplomën, kontratën e punës nëse i është vazhduar dhe CV e cila i mungonte. Ndërsa gjatë sqarimeve të ofruara, AK potencon se OE i ka ofruar kontratën, CV-në, mirëpo jo edhe diplomën... mirëpo pasi te lista qe e keni paraqit për punëtoret e keni cekur se e keni dorëzuar diplomën, andaj ju kemi kërkuar serish sqarime shtesë për herën e dytë, AK potencon se OE ankues kishte ofruar/dorëzuar dëftesën e shkollës fillore dhe jo diplomë të shkollës së mesme, e cila nuk është e pranueshme... Pastaj, në këtë letër standarde për tenderuesin e eliminuar, AK vazhdon arsyetimin e eliminimit edhe për teknikët e tjerë...

Lidhur me arsyet e eliminimit të cekura më lart, ekspertja shqyrtuese sqaron se autoriteti kontraktues, konkretisht komisioni i vlerësimit të ofertave dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve duhet ti përmbahet kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe të bëjë vlerësimin e tenderëve sipas kriterëve që janë përcaktuar në dosje të tenderit, si dhe rregullave të kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 59 të LPP-së. AK në dosje te tenderit lidhur me këtë kërkesë, konkretisht në pikën “A” kishte kërkuar inxhinier të diplomuar ose bachelor të elektroteknikës me përvojë minimumi 5 vite,

ndërsa në pikë “B” kishte kërkuar inxhinier të diplomuar ose bachelor të makinerisë me përvojë minimumi 5 vite, kurse në pikën “C” nuk kishte përcaktuar kualifikimin arsimor por kishte kërkuar 3 ekupe me nga 2 teknike dhe me përvojë minimumi 3 vite në punë të ngjashme. Nga kjo kërkesë kuptohet se për pikën “A” dhe “B” ka përcaktuar qartë kualifikimin arsimor duke kërkuar diplomën me titull inxhinier të diplomuar ose diplomë bachelor, kurse për pikën “C” NUK ka përcaktuar apo saktësuar kualifikim shkollor diplome. Meqenëse tek pika “C” është lënë kërkesa e përgjithësuar duke mos e saktësuar nivelin e kualifikimit arsimor, ekspertja shqyrtuese konsideron se AK është dashur ta bëjë vlerësimin dhe ekzaminimin e tenderëve në harmoni me kërkesën si në pikën “C” për teknikët dhe jo të bëjë vlerësimin për teknikët me kërkesën e vendosur në pikën “A” dhe “B”. Lidhur me këtë, neni 56 i LPP-së ka përcaktuar se autoriteti kontraktues nuk do të eliminojë një tenderues për një kriter që nuk ka qenë në njoftimin për kontratë apo dosje të tenderit. Andaj, ekspertja shqyrtuese vlerëson se arsyetimi i AK-së bie ndesh me nenin 56, par. 3 të LPP-së, ku është përcaktuar që:

nderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociatë, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Një interpretim i tillë është po ashtu i bazuar në “Parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP-së”, ku konform RRUOPP, gjegjësisht nenit 41.3 pika 5 potencohet “Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuar në njoftim për kontratë të/dosje të tenderit mund të përdoren si bazë për vlerësim”. Ekspertja shqyrtuese edhe njëherë rikujton kërkesën mbi mundësitë teknike dhe /ose profesionale 9.1&9.2 AK-së, me theks të veçantë pikën “c”:

| | punë në punë të ngjashme. | |

Ekspertja shqyrtuese e ri përsërit se AK nuk ka kërkuar asnjë dëshmi dokumentare për kërkesën

c.3 ekupe me nga 2 teknike. Minimumi 3 vite përvojë punë në punë të ngjashme. Aq më pak, në kërkesën e vendosur AK nuk kishte kërkuar kualifikim shkollor apo DIPLOMA siç pretendon autoriteti kontraktues. Në lidhje me teknikun Bashkim Rafuna, për të cilin në raportin paraprak të ekspertit sipas ankesës 522/22, fq. 10 të raportit është konstatuar si në vijim:

AK-së për eliminimin e OE ankues “Uplift L.L.C & Intrast” SHPK -Prishtinë nuk qëndron.

| 15 | Aktuarit i gjatit | 16/01/2022 |

Pra, në raportin paraprak ishte cekur tekniku Bashkim Rafuna e plotëson kërkesën e AK-së, i cili ishte në mesin e 6 teknikëve, ndërsa AK me rastin e rivlerësimit e largon këtë teknik me arsyetimin se nuk posedon *diplomë të pranueshme*. Ekspertja shqyrtuese edhe tani konsideron se Bashkim Rafuna e plotëson kërkesën e AK-së sepse për teknikët nuk është kërkuar diplomë siç pretendon AK. Andaj, nëse e marrim parasysh listën e teknikëve (1. Fatos Maloku, 2. Arbër Sadiku, 3. Ardian Ferizi, 4. Fatmir Berisha dhe 5. Florian Sadiku) të cilët i ka pranuar AK se e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit, si dhe teknikun Bashkim Rafuna për të cilin ishte konstatuar në raportin paraprak se e plotëson kërkesën e AK-së për përvojën prej 3 viteve në punë të ngjashme, ekspertja vlerëson se AK gjatë vlerësimit dhe ekzaminimit të tenderëve nuk ka zbatuar drejtë nenin 59 të LPP-së.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se tekniket e cekur më lartë kanë qenë në listën e punëtoreve të dorëzuar nga OE ankues me tender/ofertë.

Provë: Lista e Punëtoreve të dorëzuar me tender nga OE ankues

14	Emri i punëtorit	Vlerësimi	Titulli	Emri i punëtorit, titulli, diploma
----	------------------	-----------	---------	------------------------------------

Ndërsa lidhur me sqarimet shitesë të dërguara nga OE ankues ku krahas sqarimeve të dorëzuar për listën e stafit teknik të cilët kanë qenë të dorëzuar me tender në momentin e ofertimit OE ankues potencon se meqenëse periudha vlerësuese është tej zgjatur nga ana e AK-së, andaj edhe stafi teknik ka bërë lëvizje, ku dy nga tekniket nuk janë më në marrëdhënie pune me kompaninë e tyre Arian Kosumi dhe Xhevdet Pajaziti, OE ankues me sqarime ka dorëzuar edhe listën shitesë të stafit të rregullt stafit të ri të cilët tani janë të angazhuar në punë ekspertja shqyrtuese sqaron se kjo listë e punëtoreve/stafit nuk ishte e përfshirë në listën e punëtoreve të dorëzuar me tender dhe nuk ka qenë pjesë e dokumentacionit të dorëzuar me ofertë andaj kjo listë e stafit nuk merret parasysh sepse pranimi i tyre përbën ndryshim material dhe është në kundërshtim me nenin 59.2 të LPP-së. *"Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues"*.

Provë: Lista e Punëtoreve të dorëzuar me sqarime shitesë nga OE ankues

ANEKSI nr.1. me date 01.04.2022

I KONTRATES SE PUNES, lidhur me date 01.11.2021

Ndërmjet:

UPLIFT LLC me NUI: 811856965, Adresa: Rruga C, Blloku A4, nr:156 10000 Prishtinë (më tutje në tekst: PUNËDHËNËSI),

dhe

Bashkim Rafuna, nr. personal: 1234835471, datëlindja: 22.06.1992, adresa: Prishtinë (më tutje në tekst I PUNËSUARI).

NDRYSHIMET:

NENI 2.1. Zgjatet afati i kontrates ne kohe te pacaktuar

NENI 5.2. Paga Bruto e të Punësuarit caktohet në lartësi prej **750 euro/muaj** (shtatëqind e pesëdhjetë euro)

Te gjitha nenet e tjera mbesin te pa-ndryshuara.

PUNËDHËNËSI

UPLIFT LLC



I PUNËSUARI

Bashkim Rafuna

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, propozimi ynë për AK-Komunën e Prishtinës, është që lëndën ta kthej në ri vlerësim me qëllim që të aplikohen në tërësi dispozitat dhe parimet e LPP-së, konkretisht neni 59 të LPP-së, vlerësimi dhe ekzaminimi të tenderëve ta beje në bazë të kërkesave të vendosura nga vet AK.

Ndërsa lidhur me sqarimet shitesë të dërguara nga OE ankues ku krahas sqarimeve të dorëzuar për listën e stafit teknik të cilët kanë qene të dorëzuar me tender në momentin e ofertimi OE ankues potencon se meqenëse periudha vlerësuese është tej zgjatur nga ana e AK-së, andaj edhe stafi teknik ka bërë lëvizje, ku dy nga teknikat nuk janë më në marrëdhënie pune me kompaninë e tyre Arian Kosumi dhe Xhevdet Pajaziti, OE ankues me sqarime ka dorëzuar edhe listën shitesë të stafit të rregullt stafit të ri të cilët tani janë të angazhuar në punë ekspertja shqyrtuese sqaron se kjo listë e punëtoreve/stafit nuk ishte e përfshirë në listën e punëtoreve të dorëzuar me tender dhe nuk ka qenë pjesë e dokumentacionit të dorëzuar me ofertë andaj kjo listë e stafit nuk merret parasysh sepse pranimi i tyre përbën ndryshim material dhe është në kundërshtim me nenin 59.2 të LPP-së. *"Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues"*.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhenë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij si dhe mbështet rekomandimin e

ekspertit që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 dhe 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Uplift L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: